

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data: 06.12.2024

OPERATORIT EKONOMIK “LIGUS” SHPK

Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati Lani Shpk, Shallvare, kati 5, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - mallra.**

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-13327-07-16-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje automjete zjarrëfikëse”.**

Kohëzgjatja e kontratës: Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë pune. Lejohet lëvrimi i pjesshëm i mjeteve, brenda këtyre afateve.

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i kontratës*): Buletini Nr.40 datë 22.07.2024

Publikimet e mëparshme (*njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 58 datë 9 Shtator 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Mektrin Motors” SHPK

NIPT K51408501P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 52,500,000 [pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë] lekë pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. Operatori ekonomik “Ligus” SHPK,

NIPT L51523001S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 62,895,000 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. Operatori ekonomik “Sparkle 32” SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

NIPT L51327014R

Numri i NIPT-it

Vlera : 65,400,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind mijë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” sh.p.k, NIPT K51408501P

Për arsyet e mëposhtme:

- **1.** Në pikën 2, të shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë: [...] b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Në seksionin 3 “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon: *3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë.*

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “MEKTRIN MOTORS” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Formulari i sigurimit të ofertës lëshuar më 07.08.2024, të paraqitur me nr.4832 BND00115607 në të cilin parashikohet se: “[...] ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës], 150 (njëqind e pesëdhjetë ditë) nga dt.16.08.2024.

Përsa më sipër, operatori ekonomik Mektrin Motors shpk nuk plotëson pikën 1.b të kriterëve të vecanta për kualifikim ku thuhet se ofertuesi duhet të paraqesë: Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3;

Sa më sipër KVO konstaton se, operatori ekonomik “Mektrin Motors” shpk nuk plotëson pikën 1.b të kriterëve të vecanta për kualifikim ku thuhet se ofertuesi duhet të paraqesë: Sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3, në të cilin është parashikuar periudha e vlefshmërisë së ofertës 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë. KVO, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik konstaton se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka dorëzuar formularin e sigurimit të ofertës të paraqitur me nr. 4832 BND00115607 të lëshuar në datën 07.08.2024 i cili fillon datën e mbylljes së ofertave 16.08.2024 dhe afati i vlefshmërisë së saj është deri më 13.01.2025. Gjithashtu ky operator në plotësim të kësaj pike ka dorëzuar edhe formularin e sigurimit të ofertës sipas shtojcës 3 i cili është i vlefshëm për një afat prej 150 (njëqind e pesëdhjetë ditë) ose 100 (njëqind) ditë më pak se afati i kërkuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Referuar edhe vendimit të KPP-së nr.666/2021 ku për të njëjtin rast është marrë vendim si më poshtë:

“Sa më sipër kpp gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si

synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "x" Shpk nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit."

Gjithashtu, referuar DST, Udhëzime për Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. Përgatitja e ofertave, nën-pika 9/1 periudha e vlefshmërisë së ofertës, citohet shprehimisht: **1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës pas afatit të paraqitjes së ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor; Oferta për një periudhë të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.**

- **2.** Operatori ekonomik "MEKTRIN MOTORS" shpk nuk plotëson pikën 2.4.3 të Kriterëve të Veçanta për kualifikim ku kërkohet të paraqitet **2.4.3.** *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga Distributori i Autorizuar për mallrat e kërkuara. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit /distributorit të autorizuar si telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet të vërtetohet e dokumentuar lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit për mjetet e ofruara.*

Në përgjigje të kërkesës së AK, OE "Mektrin Motors" shpk ka dërguar shkresën me nr. 40089 prot., datë 21.10.2024, pranë AK, në përmbajtje të së cilës gjendet Autorizimi nga kompania "Hubei Chusheng Vehicle Co., Ltd (CSC Truck)" për Mektrin Motors shpk, i pajisur me Vërtetim Përkthimi Nr. Rep 1629 datë 13.08.2024. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se OE, dokumentacionit është fotokopje e panjehësuar me origjinalin, por vetëm vërtetim përkthimi, duke mos qenë në përputhje me kërkesat e DST: të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta konsiderohen kushte për skualifikim.

- **3.** Operatori ekonomik "Mektrin Motors" shpk nuk plotëson **pikën 2.4.4** të kriterëve të vecanta për kualifikim ku kërkohet të paraqitet katalogu ose skeda teknike e prodhuesit ku të tregohen karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, të cilat duhet të përmbushin plotësisht specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Shënim: Pjesët/ Fragmentet e Katalogut/ ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilitvarti katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST.

Operatori ekonomik "MEKTRIN MOTORS" SHPK në përmbushje të kësaj pike ka paraqitur dy dokumente të ndryshme të titulluar "Skeda teknike te kerkuara dhe permbushura" dhe "Katalog zjarrfikëse anglisht dhe te përkthyer ne shqip". Nga verifikimi i këtyre dokumenteve vihet re se operatori ekonomik ka paraqitur 2 versione të ndryshme dhe dy palë specifikime të ndryshme për të njëjtin produkt të ofertuar. Nisur nga fakti se për këtë

procedurë prokurimi nuk pranohen variantet atëherë rrjedhimisht ky operator duhet të paraqiste vetëm një dokument teknik në përmbushje të kësaj pike katalog ose skede teknike ashtu siç përcaktohet në kriterin 2.4.4. Paraqitja e dy katalogëve/skedave teknike për të njëjtin artikull sjell konfuzion për autoritetin kontraktor pasi është e pamundur të përcaktohet produkti i saktë dhe specifikimet e sakta të ofertuara nga ky operator kur kemi të bëjmë vetëm me një lloj produkti të vetëm për këtë procedurë prokurimi. Nga verifikimi i mëtejshëm i specifikimeve teknike që përmban katalogu dhe specifikimet teknike që përmban skeda teknike e paraqitur nga ky operator vihet re se në skedën teknike prodhuesi ka deklaruar se i plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara por nga ana tjetër në katalogun teknik po të këtij prodhuesi nuk verifikohet se plotësohet ose nuk shfaqet presioni i pompës së zjarrfikëses që kërkohet 1.3Mpa për prurje 40 L/s, vakumi maksimal 85kpa dhe koha e primimit minimumi 40s. Gjithashtu tubacioni i thithjes është kërkuar 1 DN125 por në katalog është 1 DN100, tubacioni në hyrje është kërkuar 2 DN50 në të dyja krahët dhe 1 DN70 por në katalog është ofertuar 1 DN65.

KVO arrin në konkluzionin se oferta teknike e paraqitur nga ky operator ekonomik lë vend për interpretim dhe konfuzion pasi në rast se ky prodhues do t'i plotësonte kërkesat teknike atëherë do të mund t'i paraqiste ato nëpërmjet një katalogu të saktë dhe jo me anë të një table ku për secilën kërkesë deklaron që e plotëson. Autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitjen e katalogut për të verifikuar të gjitha detajet teknike më të rëndësishme për këto mjete specifike, operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur një katalog të saktë ku për secilën kërkesë teknike të kishte modelin dhe kodin e ofertuar si dhe përshkrimin teknik të ofertuar për atë pjesë. Pra për Pistoletën e shuarjes së zjarrit në katalog është deklaruar modeli WST PL 8/32 i cili i plotëson specifikimet por nga ana tjetër për pompën e zjarrfikëses në katalog është deklaruar modeli Darley KSP750 i cili nuk tregon se sa është prurja për 1.3mpa ose sa është presioni për 40L/s, gjithashtu nuk tregon se sa është koha e primimit. Ndërkohë në skedën teknike ky prodhues ka deklaruar se i plotëson këto parametra por pa i vërtetuar ato me modelet e sakta të ofertuara në mënyrë që edhe KVO të bëjë verifikimet e saj. E njëjta metodologji ofertimi është përdorur për të gjitha komponentët dhe pjesët e tjera të automjetit zjarrfikës. Specifikimet teknike të deklaruara në skedën teknike nuk vërtetohen me katalogun që ka paraqitur. Skeda teknike mund të përdoret si dokument plotësues për të paraqitur parametra/specifikime të cilat në katalog ndoshta mungojnë por nuk mund të paraqesë vlera të ndryshme/kontradiktore nga ato të katalogut. Gjykojmë se oferta teknike e paraqitur nga MEKTRIN MOTORS është e pasaktë pasi për të njëjtin automjet janë ofertuar dy variante të ndryshme me specifikime të ndryshme. Kjo mënyrë ofertimi sjell direkt konfuzion për autoritetin dhe për grupin e marrjes në dorëzim në rast shpalljes fitues të këtij operatori pasi në realizimin e kontratës grupi i marrjes në dorëzim do t'i duhet të vlerësojë/pranojë një model automjeti i cili i përket ose skedës teknike ose katalogut. Pra në këto kushte kur OE ka paraqitur dy variante atëherë AK nuk mund të vlerësojë se cili prej tyre është varianti që do dorëzohet në fazën e realizimit të kontratës.

Gjithashtu dokumenti i paraqitur **“Skeda teknike të kërkuara dhe përmbushura”** është fotokopje e panjësuar me origjinalin, por vetëm Vërtetim përkthimi, duke mos qenë në përputhje me kërkesat e DST: **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 **“Për prokurimin publik”**, dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 **“Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”** (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik **“Mektrin Motors” sh.p.k** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme.**

2. Operatori ekonomik “SPARKLE 32” sh.p.k, NIPT L51327014R

Për arsyet e mëposhtme:

- **1.** Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 1) d. “Lista e cmimeve të artikujve sipas Shtojcës 2” referuar Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së , pasi lista e cmimeve dorëzuar nga operatori ekonomik “Sparkle 32” shpk nuk është dorëzuar në formatin e publikuar në DST. Operatori nuk duhet të ndërhyjë në formatin e publikuar nga autoriteti kontraktor ndaj rrjedhimisht gjykojmë se plotësimi i Shtojcës 2 është i parregullt dhe ky operator duhet të s’kualifikohet.

Gjithashtu, referuar DST, Udhëzime për Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, nënpika 4 Formularët e tenderit dhe Listat Çmimesh, citohet shprehimisht: **4. Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.**

- **2.** Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.1 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”* Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar asnjë dokument që vërteton plotësimin e kriterit të mësipërm, si rrjedhim KVO është përpara faktit që nuk mund të bëj gjykoj/vlerësoj përsa i përket kapacitetit financiar dhe ekonomik të operatorit.
- **3.** Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.4.2 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: *“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.B, sipas Udhëzimit Nr. 1546 datë 29.03.2016, “Blerja, shitja e mjeteve me motorr dhe rimorkio”, ose licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku operatori ekonomik ofertues ka selinë, në rastin e operatorëve ekonomike të huaj.”* Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar asnjë dokument që vërteton plotësimin e kriterit të mësipërm, si rrjedhim KVO është përpara faktit që nuk mund të bëj gjykoj/vlerësoj përsa i përket kapacitetit teknik të operatorit.
- **4.** Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1. të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit të DST-së ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.” Operatori ka paraqitur kontrata dhe vërtetime realizimi ose fatura të ngjashme të kryera pranë tre enteve publike gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së kontratës por shumica e të tre furnizimeve të ngjashme nuk plotëson kriterin prej 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, kriter i vendosur bazuar

në nenin 40 pika 4 e VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", dhe të Kreut X, Nenit 82 pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon njëzëri se oferta e Operatorit ekonomik "**Sparkle 32**" **sh.p.k** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**Operatori ekonomik "LIGUS" SHPK** me adresë: Rruga "Reshit Çollaku", Pallati Lani Shpk, Shallvare, kati 5, Tiranë], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 62,895,000 (gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh / totali i pikëve të marra [_____] identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë me adresë: Blv "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Vendimi përfundimtar i KPP për trajtimin e ankesës mban numrin 1684/2024, datë 27.11.2024.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Zëvendëskryetar / Person i autorizuar